

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	DEL FOTO: Ky është “Tani i Ruzhdiut”, 44-vjeçari që u qëllua me breshëri plumbash në Sarandë, vjet u a rrestua për plagosjen e Lamajt
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/del-foto-ky-eshte-tani-i-ruzhdiut-44-vjecari-qe-u-qellua-me-bresheri--i401657
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 08:51:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 08:47:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	becde0dffcd403314599cba10deed6920ad938ae9b229daac2102c00806ce429
TEKSTI	d7eeac90d2a805c387e6f158032a56d32fad5ce6fac4750edc227f9fc7bad9fa
PAMJA	38e3947c7e5587d458798f11f381590c0c1cf23ca52ccd70cc148cad68e4d9a8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7fd85e031e7fbb34afcbdc25b90e154459d9ddb69e0d6398d25ec09be3be900b
E MËPARSHMJA	c8f0e93f6e981306e1e34f6edd200af0f841b3037f7772e26177d5cca2f4f19d
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7fd85e031e7fbb34afcbdc25b90e154459d9ddb69e0d6398d25ec09be3be900b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

Aktualitet

20 Shtator 2026, 10:47

DEL FOTO: Ky është "Tani i Ruzhdiut", 44-vjeçari që u qëllua me breshëri plumbash në Sarandë, vjet u arrestua për plagosjen e Lamajt



Shkruar nga Newsbomb



Pamje nga vendi i ngjarjes hde Artan Myrtaj

Personi që shihni në foto është 44-vjeçari Artan Myrtaj, i cili u ekzekutua këtë të diel në qendër të qytetit të Sarandës, teksa ishte i shoqëruar nga nëna e tij.

Ngjarja e rëndë ndodhi në zonën pranë ish-agjencisë së vjetër, ku dy persona të maskuar, të cilët lëviznin me motor dhe mbanin skafandra, dyshohet se iu afruan 44-vjeçarit dhe hapën zjarr në drejtim të tij. Myrtaj u qëllua disa herë dhe mbeti i plagosur rëndë, ndërsa për shkak të plagëve të marra humbi jetën në vendin e ngjarjes.

Nga breshëria e plumbave mbeti i plagosur edhe një kalimtar i rastit, i identifikuar si Xhevdet Skëndaj, i cili ndodhej pranë vendit ku u krye atentati.



Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Politikë

"Për Enverin yll e dritë..." Korreshi bën "lëmsh" rrejtin, vajza që recitoi poezinë për diktatorin, e persekutuar dhe e përndjekur! I ati e kishte shkruar poezinë me detyrim



Foto e Ditës

Arbëreshët dhe shqiptarët bashkohen në një mesazh për Kosovën

Zbuloi më shumë artikuj >



Artan Myrtaj

"Sarandë/Informacion paraparak Rreth orës 09:55, te ish-agjencia, në rrethana ende të paqarta, është vlarë me armë zjarri shtetasi A. M., rreth 44 vjeç, si dhe ka mbetur i plagosur shtetasi Xh. S., rreth 73 vjeç, kalimtar i rastit, i cili është transportuar në spital për ndihmë mjekësore. Shërbimet e Policisë janë vënë në ndjekje të autorëve. Janë ngritur pika kontrolli në drejtim të Vlorës dhe të Gjirokastrës", njoftoi Policia.

Në vendngjarje ka shkuar grupi hetimor dhe, nën drejtimin e Prokurorisë, vijon puna për sqarimin e rrethanave, administrimin e çdo prove që i shërben hetimit, me qëllim identifikimin dhe kapjen e autorëve.

Menjëherë pas ngjarjes, autorët u larguan me shpejtësi nga vendi i atentatit, ndërsa policia rrethoi zonën dhe nisi mbledhjen e provave që mund të ndihmojnë në identifikimin e tyre. Në fokus të hetimeve janë edhe kamerat e sigurisë së bizneseve dhe objekteve përreth, ndërsa grupi hetimor po punon për të rindërtuar lëvizjet e autorëve para dhe pas ekzekutimit. Për momentin, motivi i atentatit nuk është bërë i ditur zyrtarisht, ndërsa policia po heton në disa pista për të zbardhur rrethanat dhe shkakun e sulmit.

Artan Myrtaj, i njohur ndryshe edhe me nofkën "Tani Ruzhdiut", nuk ishte një emër i panjohur për drejtësinë shqiptare dhe rezultonte i përfshirë më herët në ngjarje kriminale. Vetëm rreth një vit më parë, emri i tij doli në një tjetër ngjarje të rëndë të ndodhur në Sarandë, ku dy persona Ernest Lamaj dhe Gëzim Hajdaraj, mbetën të plagosur me armë zjarri pas një konflikti që lidhej me një sipërfaqe toke. Në atë kohë, policia e shpalli Murtajin në kërkim dhe ai u arrestua disa ditë më vonë në kuadër të hetimeve për ngjarjen.



Sipas të dhënave të bëra publike në atë kohë, përplasja kishte nisur pas një konflikti mes disa personave, ndërsa hetuesit dyshuan se pas përplasjes fshihej një konflikt për pronësinë ose përdorimin e një sipërfaqeje toke në zonën bregdetare të Sarandës. Për këtë ngjarje, policia shpalli në kërkim disa persona dhe vijoi hetimet për të përcaktuar rolin e secilit prej tyre.

Më herët, Artan Myrtaj kishte pasur edhe probleme të tjera me drejtësinë, ndërsa rezultonte i dënuar për vjedhje. Sipas të dhënave të hetimit të bëra publike në raportimet e mëparshme, ai njihet gjithashtu si përdorues i lëndëve narkotike.

Këshilluar për ty

"O bir i nënës...", ja kush është 44-vjeçari që ra pre e atentatit në Sarandë, u vra para syve të së ëmës (PAMJE-DETAJE)

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



E Diel 11:00 Newsbomb

Hoqën dorë nga Franca, Italia dhe Tirana për të zhvilluar bizneset në Koman dhe Pogradec, Rama na prezanton me 3 sipërmarrësit



Aktualitet

"O bir i nënës...", ja kush është 44-vjeçari që ra pre e atentatit në Sarandë, u vra para syve të së ëmës (PAMJE-DETAJE)

E Diel 10:16



Aktualitet

"Kërcet" arma në Sarandë, raportohet për një viktimë, plumbat kapin dhe një kalimtar të çastit, detajet e para

E Diel 10:05 Newsbomb



E Diei 09:58

Autobusi plot me mallra kontrabandë, sekuestrohen 22 mijë euro në Gjirokastrë, prangosen dy persona



Aktualitet

Dënohen me burg dy shqiptarët në Britaninë e Madhe, u kapën duke kultivuar drogën që do të shitej deri në 400 mijë paund



Aktualitet

Pagat e magistratëve: A luftohet paligjshmëria me paligjshmëri?!

E Diei 09:32

E Diei 09:41



E Diei 08:38

Revista Newsbomb.al vjen me numrin e ri, nga sot në të gjitha pikat e shitjes! Ja artikujt që do të lexoni



Aktualitet

Ulje temperaturash dhe reshje të dendura shiu, zonat ku duhet të keni çadrën me vete

E Diei 07:03



Aktualitet

Prishtina protestoi edhe sot për çlirimtarët, emigrantët u mbledhën në Europë

E Shtunë 22:56





🕒 E Shtunë 22:30

Protesta kundër vendimit të Hagës për ish-krerët e UÇK “shkon” në SHBA, shqiptarët mblidhen të martën para OKB-së

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.